



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.
____.____.2023

Tiranë, më

VENDIM

Nr. 440, datë 19.07.2023

PËR

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, PËR VITIN
2022**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2022”, i hartuar nga relatore znj. Brikena Ukperaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2022”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE NIVELI IVLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtares bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtares pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A Njohuritë ligjore.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, natyrën juridike të saj dhe referencën relevante që gjen zbatim në zgjidhjen e çështjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- *Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:*

Gjyqtarja, referuar objektit të mosmarrëveshjes, natyrës së çështjes (*civile themeli, marrëdhënie pune, gjykim penal themeli, kërkesë e seancës paraprake ose kërkesë penale e fazës së hetimit*) apo llojit të gjykimit të zhvilluar në çështjet penale (*gjykim i shkurtuar ose gjykim me marrëveshje*), i kushton rëndësi të veçantë përshkrimit të detajuar dhe analitik të fakteve të çështjes, si të atyre me natyrë procedurale, ashtu edhe të fakteve që lidhen me themelin, duke i parashtruar ato respektivisht në pjesën e parë dhe të dytë të arsytimit të vendimit.

Paraqitja e rrethanave procedurale përbën përgjithësisht pjesën hyrëse të arsytimit të vendimit, në një nënndarje të titulluar “Procedura”, në të cilën gjyqtarja parashtron vlerësimin në lidhje me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore, si dhe përbërjen e trupit gjykues. Në vendimet penale burim vlerësimi, evidentohet se gjyqtarja i kushton rëndësi përveç vlerësimit lidhur me elementët proceduralë që lidhen

me juridiksionin, kompetencën lëndore dhe tokësore, përbërjen e trupit gjykues (elementë të cilët analizohen në çdo vendim), edhe paraqitjes dhe vlerësimit lidhur me kërkesat procedurale të palëve, sikurse është rasti i kërkesave për procedim me gjykim të shkurtuar.¹ Në vendimet penale të seancës paraprake gjyqtarja përshkruan ecurinë procedurale të çështjeve sa i përket caktimit të seancës dhe njoftimit të palëve, sipas parashikimeve të K.Pr.Penale, si dhe të drejtave procedurale të tyre.²

Përfundimisht, në vendimin nr. 86, datë 05.09.2022,³ si dhe në vendimet civile nr. 189, datë 16.06.2022 dhe nr. 220, datë 21.07.2022, nuk rezulton një nënndarje e mëvetësishme lidhur me rrethanat procedurale, duke i trajtuar këto të fundit në nënndarjen “Rrethanat e çështjes” ose “Vlerësimi i gjykatës”.

Në vijim, gjyqtarja parashtron rrethanat e faktit objekt gjykimi, në një nënndarje të titulluar “Rrethanat e çështjes”. Si në vendimet civile, ashtu edhe në ato penale, rrethanat e faktit parashtrihen në mënyrë të plotë dhe të qartë, duke integruar përmbajtjen e provave dhe analizën e tyre, duke evidentuar në këtë mënyrë marrëdhënien provë-fakt. Përfundimisht, në vendimet nr. 86, datë 23.03.2022 dhe nr. 388, datë 22.12.2022, me objekt përkatësisht dërgimin në gjyq dhe pushimin e procedimit, parashtrihen fillimisht rrethanat e çështjes dhe më pas citohen provat prej të cilave ato ekstrahohen apo rezultojnë të provuara. Në çdo rast, pavarësisht natyrës së çështjes, rrethanat e çështjes bëhen pjesë e analizës së zhvilluar në pjesën e titulluar “Vlerësimi i gjykatës”, duke i kushtuar një rëndësi specifike evidentimit të fakteve thelbësore mbi të cilat mbështetet konkluzioni i gjykatës.

- ***Identifikimi i natyrës së çështjes:***

Në të gjitha vendimet e analizuara, gjyqtarja identifikon dhe përcakton qartë dhe në mënyrë të shprehur natyrën e çështjes objekt shqyrtimi. Në çështjet me natyrë penale, natyra e çështjes përcaktohet që në pjesën e parë të arsytimit të vendimit, referuar specifikave të çështjeve konkrete (*gjykim themeli, seancë paraprake apo kërkesa në fazën e hetimeve paraprake*), duke orientuar edhe natyrën e procedimit të zhvilluar, si dhe çështjet që do të jenë objekt vlerësimi në vijim të arsytimit. Ndërkohë, në çështjet me natyrë civile, natyra e çështjes përcaktohet përmes identifikimit të marrëdhënies juridike në themel të konfliktit në gjykim, objektit dhe shkakut përkatës, identifikim i cili lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë me kompetencën lëndore dhe tokësore të gjykatës, si dhe me dispozitat ligjore në kuadër të zgjidhjes së drejtë të çështjes.

- ***Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm:***

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtëpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, por lidhet gjithashtu me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes. Në këtë drejtim, referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se në të gjitha vendimet, gjyqtarja identifikon qartë

¹Vendimet nr. 79, datë 26.04.2022 dhe nr. 47, datë 15.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

² Vendimet nr. 86, datë 23.03.2022 dhe nr. 388, datë 22.12.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

³ Për vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal.

ligjin e zbatueshëm, citon dhe analizon dispozita të ligjit material ose procedural, në shërbim të analizës ligjore të tyre dhe ndërthurjes me elementet procedurale apo faktet e çështjes mbi të cilat zbatohen këto dispozita.

Sa i përket ligjit procedural:

Në çështjet civile, gjyqtarja identifikon dhe referon në pjesën arsyetuese të vendimit, dispozitat procedurale, si më poshtë:

- nenin 12 të K. Pr. Civile në lidhje me barrën e provës;⁴
- nenin 16 të K.Pr.Civile në lidhje me detyrimin e gjykatës për të zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi;⁵
- nenin 29 të K.Pr.Civile në lidhje me çmuarjen e provave;⁶
- nenet 36/1, 41, 45 dhe 47 të K.Pr.Civile, si dhe nenin 7 të Kodit të Punës lidhur me përcaktimin e juridiksionit gjyqësor, kompetencës lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve, referuar objektit të tyre (*çështje me objekt lirim dhe dorëzim sendi, pavlefshmëri titulli ekzekutiv, marrëdhënie pune*);⁷
- nenin 201 të K.Pr.Civile në lidhje me heqjen dorë nga gjykimi;⁸
- nenin 224/a të K.Pr.Civile në lidhje me caktimin e ekspertit;⁹
- nenin 609 të K.Pr.Civile në lidhje me padinë për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv;¹⁰
- nenin 6 të K.Punës në lidhje me zbatueshmërinë në kohë të K.Punës.¹¹

Në çështjet penale, referuar natyrës së çështjes (*çështje penale e fazës së hetimit paraprak, çështje penale seancës paraprake ose themelit*), apo rritit të gjykimit (*gjykim i shkurtuar ose gjykimi me marrëveshje*), gjyqtarja identifikon dispozitat procedurale, si më poshtë:

- nenet 38-39 të K. Pr.Penale në lidhje me rregullat e marrjes në pyetje të të pandehurit;¹²
- nenet 69, 74 dhe 76 të K.Pr.Penale në drejtim të vlerësimit të çështjeve të juridiksionit, kompetencës lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtimin e çështjes;¹³
- nenin 128 të K.Pr.Penale në lidhje me pavlefshmërinë absolute;¹⁴
- nenin 152 të K.Pr.Penale në lidhje me çmuarjen e provave;¹⁵
- nenet 228 dhe 229 të K.Pr.Penale në lidhje me kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit, nenin 230 të K.Pr.Penale në lidhje me kriteret e veçanta për

⁴ Vendimi nr. 119, datë 14.04.2022 dhe nr. 220, datë 21.07.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁵ Vendimi nr. 220, datë 21.07.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁶ Po aty.

⁷ Vendimi nr. 119, datë 14.04.2022, nr. 220, datë 21.07.2022 dhe nr. 189, datë 16.06.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁸ Vendimi nr. 119, datë 14.04.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁹ Po aty.

¹⁰ Vendimi nr. 220, datë 21.07.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

¹¹ Vendimi nr. 189, datë 16.06.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

¹² Vendimi nr. 86, datë 23.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

¹³ Vendimi nr. 79, datë 26.04.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

¹⁴ Vendimi nr. 86, datë 23.03.2022 dhe nr. 47, datë 15.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

¹⁵ Vendimi nr. 79, datë 26.04.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

caktimin e masës së arrestit në burg, nenin 238 të K.Pr.Penale në lidhje me masën e sigurimit “*Arrest në burg*”;¹⁶

- nenet 251, 252, 254 dhe 258 të K.Pr.Penale në lidhje me vleftësimin e arrestimit në flagrancë;¹⁷
- nenin 261 të K.Pr.Penale në lidhje me shuarjen e masës së sigurimit, nenit 262 të K.Pr.Penale në lidhje me pasojat e shuarjes së masave të sigurimit, nenin 263 të K.Pr.Penale në lidhje me afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit dhe nenin 264 të K.Pr.Penale në lidhje me zgjatjen e paraburgimit,¹⁸ si dhe nenin 265 të K.Pr.Penale në lidhje me pezullimin e afateve të paraburgimit;¹⁹
- nenin 328/1 të K.Pr.Penale në lidhje me pushimin e akuzës, nenet 329/a dhe 329/b të K.Pr.Penale në lidhje me kërkesën për pushimin e akuzës;²⁰
- nenin 332 të K.Pr.Penale në lidhje me caktimin e seancës paraprake,²¹ nenin 332/c të K.Pr.Penale në lidhje me zhvillimin e seancës, nenin 332/ë të K.Pr.Penale në lidhje me fashikullin e gjykimit;²²
- nenin 380 të K.Pr.Penale në lidhje me provat që mund të përdoren në marrjen e vendimit;²³
- nenet 393/1 dhe 485/3 të K.Pr.Penale në lidhje me shpenzimet procedurale;²⁴
- nenet 403 dhe 405 të K.Pr.Penale, lidhur me procedimin me gjykim të shkurtuar,²⁵ si dhe nenin 406 të K.Pr.Penale, lidhur me mënyrën e caktimit të dënimit në rastet e procedimit me këtë lloj të posaçëm të gjykimit.²⁶

Në një rast, gjyqtarja ka identifikuar si ligj të zbatueshëm edhe dispozita të KEDNJ dhe Kushtetutës së R.Sh, si më poshtë:

- nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ në lidhje me procesin e rregullt ligjor.²⁷

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, referuar burimeve të vlerësimit në tërësinë e tyre, rezulton se gjyqtarja identifikon dhe/ose citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në shmangien e citimit apo të listimit të dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk referojnë drejtpërdrejt në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi.

Konkretisht:

Në vendimet civile (çështje me objekt lirim dhe dorëzim sendi, pavlefshmëri titulli ekzekutiv, marrëdhënie pune) gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në

¹⁶ Vendimi nr. 86, datë 05.09.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Vendimi nr. 47, datë 15.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

¹⁹ Vendimi nr. 79, datë 26.04.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

²⁰ Vendimi nr. 388, datë 22.12.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

²¹ Vendimi nr. 47, datë 15.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

²² Vendimi nr. 86, datë 23.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

²³ Vendimi nr. 79, datë 26.04.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

²⁴ Vendimi nr. 79, datë 26.04.2022 dhe nr. 47, datë 15.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

²⁵ Vendimi nr. 86, datë 23.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

²⁶ Vendimi nr. 47, datë 15.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

²⁷ Vendimi nr. 79, datë 26.04.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

zgjdhjen e çështjes, duke iu referuar si dispozitive materiale të Kodit Civil dhe Kodit të Punës, ashtu edhe ligjeve të posaçme apo akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës, që kanë lidhje kryesisht me:

- *Të drejtat e bashkëpronarëve*, përkatësisht nenin 200 të K.Civil;²⁸
- *Objektet e përbashkëta të ndërtesave*, përkatësisht nenin 209 të K.Civil;²⁹
- *Të drejtën e pronësisë dhe mbrojtjen e saj*, përkatësisht nenin 296 të K.Civil në lidhje me padinë e rivendikimit;³⁰
- Ligjin nr. 9072, datë 22.05.2003 *“Për sektorin e energjisë elektrike”* i ndryshuar, përkatësisht nenet 46 dhe 51 sa i takon lidhjes së energjisë elektrike pa kontratë dhe masat përkatëse që merren në rast të konstatimit të këtyre situatave, si dhe Vendimin nr. 90, datë 15.11.2010 të ERE në lidhje me faturimet nën emërtimin *“Dëm ekonomik”* dhe *“Energji e pamatur”*;³¹
- Ligjin nr. 8662, datë 18.09.2000 *“Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike”* i ndryshuar;³²
- *Marrëdhënien juridike të punës*, përkatësisht nenin 12 të K.Punës në lidhje me kontratën e punës, nenin 141 të K.Punës në lidhje me përfundimin e kontratës me kohëzgjatje të pacaktuar, neni 143 të K.Punës në lidhje me afatin e njoftimit, nenin 144 të K.Punës në lidhje me procedurën e zgjidhjes së kontratës së punës, nenin 145 të K.Punës në lidhje me shpërblimin për vjetërsi në punë, nenin 149 të K.Punës në lidhje me përfundimin e kontratës me afat të caktuar, si dhe nenet 153 dhe 155 të K.Punës në lidhje me zgjidhjen e kontratës në mënyrë të menjëhershme të pajustificuar dhe dëmshpërblimin përkatës.³³

Në vendimet penale, gjyqtarja identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, si edhe dispozitive të përgjithshme të Kodit Penal, si më poshtë:

- Në funksion të cilësimit juridik të faktit penal, identifikon nenin 76 të K.Penal në lidhje me veprën penale *“Vrasja me dashje”*,³⁴ nenin 130/a/1 të K.Penal në lidhje me veprën penale *“Dhuna në familje”*,³⁵ nenin 134 të K.Penal në lidhje me veprën penale *“Vjedhja”*,³⁶ nenin 199/a/1 të K.Penal në lidhje me veprën penale *“Ndërtimi i paligjshëm”*,³⁷ si dhe nenin 278 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”*,³⁸
- Dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, p.sh. nenin 12 të K.Penal në lidhje me moshën për përgjegjësi penale, nenin 13 të K.Penal në lidhje me lidhjen shkakësore, nenin 14 të K.Penal në lidhje me fajin, nenin 15 të K.Penal në lidhje

²⁸ Vendimi nr. 119, datë 14.04.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

²⁹ Po aty.

³⁰ Po aty.

³¹ Vendimi nr. 220, datë 21.07.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

³² Vendimi nr. 220, datë 21.07.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

³³ Vendimi nr. 189, datë 16.06.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

³⁴ Vendimi nr. 79, datë 26.04.2022 dhe nr. 86, datë 05.09.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

³⁵ Vendimi nr. 47, datë 15.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

³⁶ Vendimi nr. 388, datë 22.12.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

³⁷ Vendimi nr. 86, datë 23.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

³⁸ Vendimi nr. 86, datë 05.09.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

me dashjen,³⁹ nenin 18 të K.Penal në lidhje me kryerjen e veprës penale në gjendje të dehur,⁴⁰ nenet 22 dhe 23 të K.Penal në lidhje me kuptimin dhe përgjegjësinë për tentativën,⁴¹ nenin 25 të K.Penal në lidhje me bashkëpunimin,⁴² nenin 47 të K.Penal në lidhje me mënyrën e caktimit të dënimit, nenet 48-50 të K.Penal në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rënduese,⁴³ nenin 66 të K.Penal në lidhje me parashkrimin e ndjekjes penale.⁴⁴

Sa i përket aspektit të evidentimit të konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtarja ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret. Nga ana tjetër, nuk konstatohet asnjë rast ku analiza e konfliktit të normave të ketë qenë e domosdoshme, në mbështetje të arsytimit lidhur me zgjidhjen e çështjes.

KONKLUSIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes dhe përshkrimin e tyre duke i ndërthurur me provat e administruara në gjykim. Gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsytimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*procedurale dhe materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar në çdo rast me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes, si në ato me natyrë procedurale, ashtu edhe në ato që kanë lidhje me themelin e çështjes. Tipar karakteristik i gjyqtares është se në çdo rast citimi ose referimi i dispozitave është shoqëruar me interpretimin e tyre në mënyrë abstrakte, para aplikimit mbi faktin

³⁹ Vendimi nr. 79, datë 26.04.2022 dhe nr. 47, datë 15.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁴⁰ Vendimi nr. 47, datë 15.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁴¹ Vendimi nr. 79, datë 26.04.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁴² Vendimi nr. 86, datë 05.09.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁴³ Vendimi nr. 79, datë 26.04.2022 dhe nr. 47, datë 15.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁴⁴ Vendimi nr. 388, datë 22.12.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

konkret, ose konkluzionin e arritur. Konstatohet se gjyqtarja kryesisht përdor interpretimin literal apo sistematik të normave, interpretim i cili duke e përjasur me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, sjell si pasojë logjike konkluzionin e saj në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

- *Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm*

Në vendimet civile përgjithësisht interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj, duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative ose alternative, që të gjejë zbatim norma konkrete, por edhe në përputhje me faktin dhe provat e administruara në gjykim. Në mënyrë më specifike, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi evidentohet se gjyqtarja:

- Merr në analizë padinë e rivendikimit si një ndër paditë për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë, referuar nenit 296 të K.Civil. Në këtë kuadër, ndalet në identifikimin dhe interpretimin e tre kushteve të saj dhe konkretisht: (i) së pari, objekti i kërimit të jetë një send i luajtshëm ose i paluajtshëm dhe individualisht i përcaktuar; (ii) së dyti, paditësi është pronar i sendit në kohën e ngritjes së padisë, pra ai ka një titull të ligjshëm pronësie mbi këtë send; (iii) së treti, i padituri nuk ka asnjë të drejtë mbi sendin në pronësi të paditësit dhe e mban atë në mënyrë të paligjshme, duke mos lejuar paditësin të ushtroje tagrat që rrjedhin nga e drejta e pronësisë, si posedimin dhe gëzimin e sendit. Gjithashtu, trajton edhe kushtet që duhet të plotësojnë veprimet e të paditurit në mënyrë të tillë që të përbëjnë zhveshje nga posedimi.⁴⁵
- Trajton padinë për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv duke evidentuar si rastet e ngritjes së saj: a) kur detyrimi nuk ekziston; b) kur detyrimi është në një masë më të vogël; c) kur detyrimi është shuar më pas. Gjithashtu, sqaron barrën e provës në kuadër të kësaj padie.⁴⁶
- Interpreton nenin 12 të K.Punës në lidhje konceptin e kontratës së punës, duke evidentuar dhe analizuar katër elementët thelbësore të saj: a) ofrimi i punës apo shërbimit; b) për një periudhë kohe të caktuar apo të pacaktuar; c) nën varësinë e punëdhënësit; d) në shkëmbim të pagës.⁴⁷
- Merr në analizë institutin e zgjidhjes së kontratës së punës me afat të pacaktuar, duke u ndalur në zgjidhjen e menjëhershme të saj. Në këtë kuadër, sqaron kushtet që duhet të respektohen në mënyrë që punëdhënësi të mund të zgjidhe kontratën e punës në mënyrë të menjëhershme, duke renditur si të tilla: (i) Punëmarrësi ka shkelur një detyrim kontraktual, që rrjedh nga ligji apo kontrata (individuale ose kolektive); (ii) Kjo shkelje është kryer me faj të rëndë ose me faj të lehtë, në mënyrë të përsëritur, me gjithë paralajmërim me shkrim nga punëdhënësi; (iii) Shkelja e detyrimit me faj ka krijuar një situatë të rëndë që nuk lejon, sipas parimit të mirëbesimit, t'i kërkohet punëdhënësit vazhdimi i marrëdhënies të punës; (iv) Midis shkeljes së detyrimit me faj nga punëmarrësi dhe pushimit të menjëhershëm nga puna ekziston lidhja shkakësore.⁴⁸

⁴⁵ Vendimi nr. 119, datë 14.04.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁴⁶ Vendimi nr. 220, datë 21.07.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁴⁷ Vendimi nr. 189, datë 16.06.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁴⁸ Po aty.

Në vendimet penale gjyqtarja interpreton dispozitat materiale (nenet 76 dhe 130/a/1 të Kodit Penal) në funksion të cilësimit juridik të veprës penale dhe të përgjegjësisë së autorit në kryerjen e saj, duke bërë zberthimin e normave të pjesës së posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizës së elementëve të figurës së veprës penale për të cilën procedohet. Gjyqtarja interpreton në nivel teorik normën relevante të K.Penal, duke bërë një përshkrim të përgjithshëm në lidhje me elementët dallues të veprës penale, duke zberthyer të katër elementët e figurës së saj, përkatësisht objektin, anën objektive, subjektin dhe anën subjektive, e në vijim, duke e përqsur me faktet e provuara në gjykim, nxjerr konkluzionin në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal dhe përgjegjësinë penale të autorit.⁴⁹

Përpos interpretimit të dispozitave materiale penale të pjesës së posaçme në lidhje me kualifikimin ligjor të veprave penale përkatëse për të cilat akuzohen të pandehurit, gjyqtarja interpreton edhe dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, sikurse janë ato që lidhen me institutin e dënimit penal, kuptimin dhe parimet e caktimit të tij, si dhe elementët që duhet të mbahen në konsideratë në caktimin e masës së tij.⁵⁰

- Në lidhje me interpretimin e dispozitave procedurale të zbatueshme

Si në vendimet civile, ashtu edhe në vendimet penale, gjyqtarja i jep rëndësinë e duhur interpretimit të normës, jo vetëm sa i përket aspekteve të themelit të çështjes, por edhe atyre procedurale, në rastet kur ngrihen çështje të procedurës apo kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel. Konkretisht:

- Në çështjet civile të themelit, gjyqtarja interpreton dispozitat procedurale në drejtim të vlerësimit lidhur me juridiksionin dhe kompetencën e gjykatës për shqyrtimin e çështjes,⁵¹ të përcaktimit të barrës së provës,⁵² të së drejtës për heqje dorë nga gjykimi i një kërkimi,⁵³ të zbatueshmërisë së Kodit të Punës në kohë.⁵⁴
- Në çështjen penale të themelit ku është proceduar me gjykim të shkurtuar, gjyqtarja interpreton dispozitat procedurale në mbështetje të argumentimit të saj në lidhje me vlerësimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar,⁵⁵ duke referuar edhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë.⁵⁶
- Në vendimin me objekt dërgimin e çështjes në gjyq, gjyqtarja trajton aspektin procedural të zhvillimit të seancës paraprake referuar nenit 332/c të K.Pr.Penale, duke evidentuar qartë elementët që duhet të merren në shqyrtim nga gjykata në gjykime të kësaj natyre dhe përkatësisht: nëse konstatohet ndonjë pavlefshmëri absolute e akteve procedurale;

⁴⁹ Vendimet nr. 79, datë 26.04.2022 dhe nr. 47, datë 15.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁵⁰ Po aty.

⁵¹ Vendimet nr. 119, datë 14.04.2022, nr. 220, datë 21.07.2022 dhe nr. 189, datë 16.06.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁵² Vendimi nr. 119, datë 14.04.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁵³ Po aty.

⁵⁴ Vendimi nr. 189, datë 16.06.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁵⁵ Vendimi nr. 132, datë 13.03.2017, vendimi nr. 235, datë 25.07.2018, vendimi nr. 311, datë 24.10.2019 dhe vendimi nr. 180, datë 18.04.2017.

⁵⁶ Vendimi nr. 47, datë 15.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

ekzistenca e përgjegjësisë penale dhe cilësimi juridik i faktit; kërkesa për gjykim të shkurtuar; si dhe përmbajtja e fashikullit të gjykimit. Gjithashtu, gjyqtarja trajton institutin e pavlefshmërisë absolute dhe relative të akteve procedurale, duke evidentuar edhe dallimet midis tyre.⁵⁷

- Në vendimin me objekt pushimin e procedimit penal, gjyqtarja ndalet në konceptin e ndjekjes penale dhe rolin e prokurorisë në kuadër të saj. Gjithashtu, ajo trajton rolin e gjyqtarës të seancës paraprake në kontrollin e veprimtarisë hetimore të prokurorisë dhe disponimin përkatës në përfundimin të tij.⁵⁸
- Në vendimin me objekt vleftësimin e arrestit në flagrancë, gjyqtarja trajton konceptin e arrestit në flagrancë si një nga rastet e kufizimit të lirisë personale të individit, duke vënë theksin te kriteret ligjore që duhet të verifikojë gjykata për efekt të ligjshmërisë së tij, referuar neneve 251, 252, 254 dhe 258 të K.Pr.Penale. Gjithashtu, ajo trajton konceptin e masave të sigurimit, duke u ndalur në kuptimin, qëllimin dhe identifikimin e kushteve që legjitimojnë caktimin e tyre, si dhe kriterëve që duhen mbajtur parasysh në për efekt të individualizimit.⁵⁹

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, evidentohet kujdesi i gjyqtarës që gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes të referohen dhe zbatohen parimet e përgjithshme të së drejtës, gjë që realizohet jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti i arsytimit të vendimit. Gjyqtarja njeh, referon dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

- Parimin e ligjshmërisë – *nullum crimen, nulla poena sine culpa*;⁶⁰
- Parimin “*përtej çdo dyshimi të arsyeshëm*”;⁶¹
- Parimin e individualizimit të dënimit;⁶²
- Parimin procedural të barrës së provës në procesin civil;⁶³
- Parimin e procesit të rregullt ligjor, i cili jo vetëm referohet drejtpërdrejt në vendime në lidhje me aspekte të procedimit,⁶⁴ por rezulton edhe nga arsytimi, duke iu referuar aspekteve procedurale të gjykimit që lidhen me njoftimin dhe pjesëmarrjen e subjekteve në proces, të drejtën e mbrojtjes, etj.

Në lidhje me aftësinë e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën relevante, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjit Civil dhe Penal të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, si dhe vendimet e GJEDNJ-së*), në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë:

- Vendimet e GJEDNJ-së, përkatësisht në lidhje me çështjen “*Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë*” për efekt të standardit të vlerësimit të provave,⁶⁵ “*K&F kundër*

⁵⁷ Vendimi nr. 86, datë 23.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁵⁸ Vendimi nr. 388, datë 22.12.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁵⁹ Vendimi nr. 86, datë 05.09.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁶⁰ Vendimet nr. 79, datë 26.04.2022 dhe nr. 47, datë 15.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁶¹ Vendimet nr. 79, datë 26.04.2022 dhe nr. 47, datë 15.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁶² Po aty.

⁶³ Vendimi nr. 119, datë 14.04.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁶⁴ Vendimi nr. 86, datë 23.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁶⁵ Vendimi nr. 79, datë 26.04.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Gjermanisë” në lidhje me momentin nga i cili duhet të fillojë llogaritja efektive e heqjes së lirisë, si dhe “*K dhe F kundër Gjermanisë*”, “*Fox, Cembell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar*” dhe “*Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar*” në lidhje me konceptin “*dyshim i arsyeshem*”,⁶⁶

- Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 4, datë 10.02.2012 në lidhje me gjykimin e shkurtuar;⁶⁷
- Vendimet Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, përkatësisht vendimin nr. 7, datë 14.10.2011 në lidhje me parimin “*përtej çdo dyshimi të arsyeshem*”,⁶⁸ vendimin nr. 19/2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në lidhje me lidhje me zgjidhjen e kontratës së punës me afat të pacaktuar,⁶⁹ vendimin nr. 2, datë 29.01.2003 në lidhje me gjykimin e shkurtuar,⁷⁰ si dhe vendimin nr. 5/2013 në lidhje me konceptin “*pasoja të rënda*”,⁷¹
- Jurisprudencën jounifikuese të Gjykatës së Lartë, përkatësisht vendimin nr. 22, datë 30.01.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në lidhje me analizën juridike të veprës penale “*Vrasja me dashje*”, si dhe dallimin e saj me veprat penale “*Vrasja me paramendim*” dhe “*Vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike*”.⁷²

KONKLUZIONE:

Në tërësi, në vendimet përfundimtare, interpretimi nëpërmjet zbërthimit të kuptimit e qëllimit të elementëve të dispozitave ligjore, përveç analizës abstrakte të tyre para aplikimit mbi faktet konkrete, pasurohet me referimin në praktikën unifikuese/njehsuese të Gjykatës së Lartë dhe praktikën e Gjykatës Kushtetuese. Interpretimi i dispozitave të ligjit procedural dhe material në mënyrë të pavarur dhe në nivel shterues, para aplikimit mbi faktet e çështjes apo situatat procedurale konkrete, zë një peshë të konsiderueshme në arsyetimin e vendimeve, i mbështetur gjithmonë në parimet e përgjithshme të së drejtës. Në ato raste kur disponimet e gjykatës lidhen me kërkesa të fazës së hetimit paraprak ose dërgimin e çështjes në gjyq, interpretimi abstrakt i dispozitave ligjore edhe pse më i kufizuar, është në masën e duhur të diktuar nga lënda objekt shqyrtimi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

⁶⁶ Vendimi nr. 86, datë 05.09.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁶⁷ Vendimi nr. 47, datë 15.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁶⁸ Vendimi nr. 79, datë 26.04.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁶⁹ Vendimi nr. 189, datë 16.06.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁷⁰ Vendimi nr. 47, datë 15.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁷¹ Vendimi nr. 388, datë 22.12.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁷² Vendimi nr. 79, datë 26.04.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Shkrimi ligjor duhet të karakterizohet nga disa tipare që e bëjnë të qëndrueshëm, siç janë: qartësia, saktësia, konciziteti dhe komponenti analitik. Ai duhet të paraqesë pa ndërprerje një pamje të qartë, të shpejtë dhe të plotë të çështjes. Vendimi gjyqësor nuk duhet të dominohet nga përshkrimi i provave, por nga pjesa analitike, e cila në vetvete duhet të jetë koncize, pa përsëritje dhe të trajtojë çështjet thelbësore.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se, gjuha e përdorur nga gjyqtarja në komunikimin me palët gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara dhe vendimet përfundimtare, është në çdo rast e thjeshtë, e drejtpërdrejtë, e qartë për palët në proces, si dhe për lexuesin e akteve. Gjyqtarja përdor të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe, respekton rregullat gramatikore dhe ato të sintaksës në formimin e fjalëve dhe fjalive, duke i bërë aktet të qarta dhe të shkruara në mënyrë korrekte. Gjyqtarja përdor përgjithësisht fjali me gjatësi mesatare, të cilat janë të qarta dhe të organizuara në rrjedhë logjike të njëra tjetrës si dhe paragrafë të strukturuar, të cilët janë të lidhur me njëri-tjetrin duke treguar vijueshmëri të arsyetimit.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në proces, evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine, përgjithësisht të etiketuara, pas termit/shprehjes përkatëse në gjuhën shqipe, duke i bërë të kuptueshëm për lexuesin. Në referimin e fjalëve me karakter teknik, kryesisht në referimin e konkluzioneve të akteve të ekspertimit,⁷³ apo si pasojë e referimit në ligje të posaçëm me karakter specifik,⁷⁴ përdorimi i termave teknike është i kufizuar, i shoqëruar me shpjegimin e tij, ose rezulton i qartë nga konteksti i arsyetimit.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien e përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues.

Në të gjitha vendimet burim vlerësimi,⁷⁵ evidentohet se gjyqtarja pasqyron dhe merr në analizë elementët proceduralë, si kompetenca dhe juridiksioni, pavarësisht nëse këta elementë kanë qenë të diskutueshëm nga palët apo rrethanat e çështjes. Përgjithësisht në të gjitha vendimet e analizuara,⁷⁶ evidentohet vendosja e plotë e tekstit të dispozitave ligjore të zbatueshme. Prezenca e këtyre elementëve, edhe pse në disa raste në mënyrë tepër të detajuar, i jep qartësi elementëve proceduralë të gjykimit dhe arsyetimit të vendimit, dhe nuk cenon koncizitetin e tij.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi “shumë të larta” në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

⁷³ Vendimi nr. 79, datë 26.04.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁷⁴ Vendimi nr. 220, datë 21.07.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁷⁵ Përrjashtim bën vetëm vendimi nr. 86, datë 05.09.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, me objekt vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal.

⁷⁶ Përrjashtim bën vendimi nr. 86, datë 23.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, me objekt dërgimin e çështjes në gjyq, si dhe vendimi nr. 388, datë 22.12.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, me objekt pushimin e procedimit penal.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi. Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.

Organizimi i arsytimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kryesore të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsytimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtares në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsytimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*) etj., të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzioni i arritur.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Gjyqtarja ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar në hartimin e vendimeve. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese - arsytuese si dhe dispozitivin e vendimit.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, objekti i shqyrtimit, si dhe kërkimet përfundimtare subjekteve të pranishme në proces. Lidhur me evidentimin e subjekteve procedurale, në pjesën hyrëse të vendimeve penale me “viktimë” (të dëmtuar nga vepra), kjo e fundit evidentohet vetëm në vendimin penal nr.79 dt. 26.04.2022. Ndërsa në dy vendimet e tjera penale nr.47 dt. 15.03.2022 dhe nr. 388 dt. 22.12.2022, viktimia apo pala e dëmtuar nuk pasqyrohet në pjesën e parë të evidentimit të subjekteve procedurale, edhe pse prezenca ose jo e saj në gjykim citohet nga ana e gjyqtares në pjesën e citimit të konkluzioneve përfundimtare të palëve.

Pjesa përshkuese-arsyetuese është e ndarë në disa pjesë të listuara formalisht me tituj, si procedura, faktet e çështjes, legjislacioni i zbatueshëm, vlerësimi dhe analiza juridike e gjykatës, ku trajtohen në mënyrë të detajuar përgjithësisht: (i) elementët proceduralë të

vlerësuar nga gjykata (juridiksioni, kompetenca, formimi i trupit gjykues), vlerësimi për kërkesat procedurale të palëve, së bashku me argumentet për vendimmarrjen respektive të gjykatës lidhur me to; (ii) faktet thelbësore të çështjes (fakti penal apo faktet e çështjes civile objekt shqyrtimi), përgjithësisht të integruara me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim⁷⁷; (iii) ligjin e zbatueshëm, duke u ndalur jo vetëm tek dispozitat materiale penale dhe civile, por edhe ato të ligjit të posaçëm, ku të referon fakti juridik për zgjidhjen e çështjes; (iv) vlerësimi i gjykatës, në të cilin merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, duke mbajtur në konsideratë edhe pretendimet apo prapësimet e palëve aty ku ka të tilla, për të përfunduar me një përmbledhje dhe konkluzion mbi çështjen.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës dhe data e shpalljes së vendimit. Dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim jo vetëm disponimi i gjykatës mbi padinë e evokuar nga paditësi (pranimin apo rrëzimin e kërkesë padisë), apo në lidhje me përgjegjësinë penale të të pandehurit mbi akuzën që i atribuohet (deklarimin fajtor por edhe deklarimin e pafajshëm), apo mënyrën e disponimit në çështjet specifike të seancës paraprake (për dërgimin e çështjes në gjyq ose pushimin e procedimit penal), por njëkohësisht edhe se kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore, por masa e këtyre shpenzimeve nuk gjen pasqyrim as në dispozitivin e vendimit dhe as në pjesën arsyetuese të tij. Gjithashtu, në të gjitha vendimet objekt vlerësimi pasqyrohet e drejta e ankimit dhe afati i ushtrimit të saj.

Konstatohet se vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, elementët e parashikuar në: (i) nenin 310 të K.Pr.Civile, në vendimet civile, me përjashtim të masës së shpenzimeve (përmbajtja konkrete e detyrimit për palën që i ngarkohen); (ii) nenin 245 të K.Pr.Penale, në vendimin për caktimin e masës së sigurimit; (iii) nenin 332/e dhe 329/b të K.Pr.Penale, në vendimet seancë paraprake; (iv) nenin 383 të K.Pr.Penale, në vendimet penale. Po kështu, vendimet janë të strukturuar në paragrafë dhe nënndarje, çka lehtëson kuptueshmërinë e arsyetimit të gjykatës për çdo pretendim të ngritur, në funksion të vendimmarrjes përfundimtare.

Nga pikëpamja e përmbajtjes, mënyra e të shkruarit të vendimeve është e qartë dhe e strukturuar mirë, përgjithësisht sipas këtij rendi: trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura gjatë gjykimit, parashtrimi i rrethanave të faktit, ligji i zbatueshëm, trajtimi i çështjeve që duhet të shqyrtohen nga gjykata, duke përfshirë analizën e pretendimeve dhe prapësimeve të palëve dhe në fund të pjesës arsyetuese, përfundimet e arritura nga gjyqtarja. Gjithashtu, konstatohet që për çdo nënndarje apo njësi e vendimit të jenë vendosur titujt përkatës, për orientimin e duhur të palëve dhe gjykatave më të larta mbi përmbajtjen e vendimit.

⁷⁷ Përjashtimisht, në vendimet nr. 86, datë 23.03.2022 dhe nr. 388, datë 22.12.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, me objekt përkatësisht dërgimin në gjyq dhe pushimin e procedimit, parashtrihen fillimisht rrethanat e çështjes dhe më pas citohen provat prej të cilave rezultojnë ato.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi “Mbi mesataren” në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit. Struktura e mirëorganizuar është e dukshme në aspektin vizual, me përjashtim të dy vendimeve gjyqësore ku nuk pasqyrohen të dhënat mbi viktimën si subjekt procedimi penal. Në drejtim të përmbajtjes, struktura e vendimit është e ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, por në asnjë rast nuk evidentohet masa e shpenzimeve gjyqësore, çka e bën të paqartë masën e detyrimit për palën që ato i ngarkohen.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” vlerësohet “Mbi mesataren” duke u pikëzuar me 8 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik

Në të gjitha vendimet burim vlerësimi, rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, gjithnjë i detajuar, i plotë, i qartë dhe gjithëpërfshirës. Evidentohet se gjyqtarja i ka kushtuar rëndësi dhe kujdes të posaçëm analizës së faktit, duke integruar edhe provat mbi të cilat mbështetet kjo analizë, duke pasqyruar në këtë mënyrë marrëdhënien provë-fakt, në funksion të zbërthimit dhe zgjidhjes së çështjes në përputhje me ligjin e zbatueshëm. Gjithashtu, evidentohet se gjyqtarja integron në mënyrë logjike dhe në vendin e duhur dispozitat ligjore të zbatueshme, të cilat kryesisht pas citimit ose referimit të tyre, shoqërohen me interpretim dhe më pas me zbatim mbi faktet e çështjes, duke pasuruar argumentimin logjik me qëndrimet e praktikës gjyqësore.

Në çështjet civile gjyqtarja i kushton rëndësi analizës së instituteve të caktuara të së drejtës, referuar thelbit të mosmarrëveshjes, p.sh: (i) Padisë së rivendikimit si një ndër paditë për mbrojtjen e së drejtës së pronës, referuar nenit 296 të K.Civil;⁷⁸ (ii) Padisë për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv referuar nenit 609 të K.Pr.Civile;⁷⁹ (iii) Zgjidhjes së kontratës së punës, me fokus te zgjidhja e menjëhershme e pajustificuar e saj dhe pasojat përkatëse, duke sjellë në vëmendje edhe jurisprudencën unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.⁸⁰

Në çështjet penale,⁸¹ gjyqtarja i kushton rëndësi të veçantë analizës së integruar të fakteve të provuara në raport me katër elementët e figurës së veprës penale për të cilën procedohet, duke lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë provat me faktet të cilat ato mbështesin, si dhe elementët përkatës të figurës së veprës penale. Në këtë mënyrë evidentohet qartë dhe natyrshëm lidhja shkak-pasojë dhe konkluzioni i arritur për

⁷⁸ Vendimi nr. 119, datë 14.04.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁷⁹ Vendimi nr. 220, datë 21.07.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁸⁰ Vendimi nr. 189, datë 16.06.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁸¹ Vendimet nr. 79, datë 26.04.2022 dhe nr. 47, datë 15.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

provueshmërinë e elementëve të figurës së veprës penale. Gjithashtu, gjyqtarja i kushton vëmendje kushteve dhe kriterëve ligjore të individualizimit të dënimit, duke i identifikuar fillimisht ato në mënyrë abstrakte dhe duke i analizuar më pas në mënyrë konkrete në rrethanat e çështjes në gjykim.

*Në çështjet seancë paraprake,*⁸² evidentohet sërish i njëjti kujdes i gjyqtarës në analizën dhe argumentimin logjik të ndjekur në arsyetimin e vendimit. Konkretisht, përshkrimi i detajuar i fakteve të rezultuara, ndiqet nga analiza abstrakte e ligjit të zbatueshëm, për të verifikuar më pas aplikimin e tij konkret në çështjen në gjykim. Po e njëjta logjikë është ndjekur edhe në vendimin me objekt vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit.⁸³

Referuar analizës së mësipërme, konstatohet se mënyra e organizimit të arsyetimit ligjor ndjek rregullin: referim ose citim i ligjit; interpretim abstrakt i tij; zbatim i ligjit mbi faktin konkret dhe konkluzioni i gjykatës. Në këtë mënyrë, evidentohet qartë lidhja shkak-pasojë dhe konkluzionet vijnë si rezultat i zhvillimit logjik të koncepteve ligjore.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar në atë pjesë të arsyetimit me të cilën lidhet pretendimi. Pretendimet e palëve gjithnjë janë marrë në shqyrtim dhe analizuar, si pjesë e arsyetimit ligjor në pjesën përkatëse të arsyetimit që ka të bëjë me pretendimin konkret, duke u analizuar dhe duke iu dhënë në përgjigje të argumentuar referuar bazueshmërisë në prova dhe në ligj.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në treguesin “*Cilësia e analizës dhe argumentit logjik*”. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim-konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të vetë zhvillimit të mendimit juridik të gjyqtarës në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsyetimit. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri dhe spikat interpretimi individual i ligjit, si dhe mbështetja e tij në qëndrimet e praktikës gjyqësore, duke pasuruar arsyetimin e vetë gjyqtarës. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, në shërbim të zgjidhjes së çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” është Shumë e lartë” duke e pikëzuar me 25 pikë.

⁸² Vendimet nr. 86, datë 23.03.2022 dhe nr. 388, datë 22.12.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

⁸³ Vendimi nr. 86, datë 05.09.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
98	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtarja përdor kohën e saj si kur gjykon e vetme ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtarës për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore

Nga analiza e burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezultojnë 68 çështje për të cilat ligji procedural parashikon afat ligjor shqyrtimi, nga të cilat 4 çështje kanë përfunduar tej këtij afati. Sipas kategorive, rezultojnë të gjykuara tej afatit ligjor, çështjet si më poshtë:

- (i) 1 çështje nga kategoria “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, përkatësisht çështja me nr. rendor 16 me objekt “Kundërshtim veprimesh përmbarimore”, e cila është gjykuar në afatin 238 ditë, ndërkohë që neni 610 i K.Pr.Civile, ka parashikuar afatin ligjor 20 ditë.*
- (ii) 1 çështje nga kategoria “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, përkatësisht çështja me nr. rendor 44, me objekt “Ndihmë juridike”, e cila është gjykuar në afatin 46 ditë, ndërkohë që neni 22 i ligjit 111/2017, ka parashikuar afatin ligjor 5 ditë.*
- (iii) 2 çështje nga kategoria “Penale seancë paraprake”, përkatësisht çështjet me nr. rendor 1 dhe 5, me objekt “Dërgim çështje në gjyq”, të cilat janë gjykuar në afatet 391 ditë dhe 37 ditë, ndërkohë që neni 332 i K.Pr.Penale ka parashikuar afatin ligjor të gjykimit 30 ditë.*

Sa më sipër, rezulton se gjyqtarja {...} ka gjykuar 6% të çështjeve jashtë afatit ligjor, e cila sipas Metodologjisë pikëzohet me 15 pikë.

Gjyqtarja në Formularin e Integruar të Vlerësimit ka argumentuar shkaqet që kanë ndikuar në numrin e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor, duke u ndalur fillimisht në një analizë të përgjithshme referuar kategorive të çështjeve të cilat rezultojnë të jenë gjykuar jashtë afatit. Gjithashtu, gjyqtarja ka kërkuar të mbahen në konsideratë edhe shkaqet si vijon: fakti se nuk është llogaritur diferenca e kohës së regjistrimit me kohën e shortimit dhe kalimit të dosjes tek gjyqtari i çështjes; periudha e lejes së zakonshme vjetore (35 ditë kalendarike); periudha e mbartjes së dosjeve në gjykatë; shkaqet shëndetësore të parashtruara herë pas here.

KONKLUZIONE:

Duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, gjyqtarja pikëzohet me pikët maksimale pasi përqindja e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit, rezultojnë të jetë 6%, e cila përkon me nivelin maksimal të pikëzimit për këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar përqindjes së çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor dhe shkallës së përgjegjësisë së gjyqtarës, në lidhje me këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore

Nga analiza e burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, duke iu referuar standardit minimal për çdo kategori çështjes, të përcaktuar në vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së, rezultojnë se gjyqtarja ka gjykuar në total 212 çështje për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, nga të cilat 29 çështje jashtë këtij afati. Sipas kategorive, rezultojnë të gjykuara tej afatit ligjor, çështjet si më poshtë:

- (i) **3 çështje** nga kategoria “*Civile të përgjithshme me palë kundërshtare*”, përkatësisht çështjet me nr. rendor 2, 3 dhe 9, të cilat janë gjykuar në afatin 313 ditë, 278 ditë dhe 463 ditë, ndërkohë pika 5/e e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 6 muaj.
- (ii) **4 çështje** nga kategoria “*Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”, përkatësisht me nr. rendor 1-3 dhe 29, të cilat janë gjykuar në afatin 104 ditë, 132 ditë, 104 ditë dhe 132 ditë, ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj.
- (iii) **10 çështje** nga kategoria “*Familjare me palë kundërshtare*”, përkatësisht çështjet me nr. rendor 1-3, 9, 12, 13, 15, 20, 34 dhe 38, të cilat janë gjykuar në afatin 124 ditë, 133 ditë, 122 ditë, 125 ditë, 122 ditë, 177 ditë, 280 ditë, 122 ditë, 135 ditë dhe 163 ditë, ndërkohë, pika 5/d e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 4 muaj.
- (iv) **3 çështje** nga kategoria “*Familjare pa palë kundërshtare*”, përkatësisht çështjet me nr. rendor 2, 3 dhe 5, të cilat janë gjykuar në afatin 183 ditë, 134 ditë dhe 181 ditë, ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj.

- (v) **2 çështje** nga kategoria “*Penale krime*”,⁸⁴ përkatësisht çështjet me nr. rendor 3 dhe 6, të cilat përfshijnë çështje me objekt vepra penale që dënohen deri në 10 vjet burgim dhe janë gjykuar në afatin 309 ditë dhe 418 ditë, ndërkohë, pika 5/a e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 9 muaj (270 ditë).
- (vi) **1 çështje** nga kategoria “*Penale kundërvajtje*”, përkatësisht çështja me nr. rendor 8, e cila është gjykuar në afatin 517 ditë, ndërkohë, pika 5/a e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 4 muaj (120 ditë).
- (vii) **5 çështje** nga kategoria “*Seancë paraprake*”, përkatësisht çështjet me nr. rendor 2, 6, 11, 17 dhe 18, të cilat janë gjykuar në afatin 77 ditë, 76 ditë, 72 ditë, 100 ditë dhe 79 ditë, ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj.
- (viii) **1 çështje** nga kategoria “*Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*”, përkatësisht çështja me nr. rendor 2, e cila është gjykuar në afatin 72 ditë. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj.

Gjyqtarja në Formularin e Integruar të Vlerësimit ka argumentuar shkaqet të cilat kanë ndikuar në tejkalimin e afateve orientuese të përcaktuara në vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së, duke theksuar se tejkalimi i afatit orientues ka ardhur për shkak të sjelljes së palëve në proces ose me qëllim respektimin e procesit të rregullt gjyqësor si p.sh realizimi i njoftimeve, kërkesat e bazuara të palëve për shtyrje të seancës etj. Gjithashtu, ajo ka cituar edhe grevën/bojkotit e zhvilluar nga Avokatët në Republikën e Shqipërisë për një periudhë relativisht të gjatë.

Në tërësi, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor (29 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor (212 çështje), rezulton se gjyqtarja ka gjykuar jashtë standardit minimal kohor 13.7% të çështjeve, përqindje e cila sipas Metodologjisë së Pikëzimit, pikëzohet me 4 pikë. Ndërkohë, rezulton se për çështjet që i përkasin kategorisë “*Familjare me palë kundërshtarë*”, me nr. rendor 1, 3, 9, 12 dhe 20, afati orientues është tejkaluar nga dy ditë deri në pesë ditë, pra në mënyrë të papërfillshme referuar afatit 4 muaj të parashikuar nga pika 5/d e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të ish-KLD-së për këtë kategori. Po kështu, nëse në përlllogaritjen e afatin të gjykimit nuk do të përfshihej periudha kur gjyqtarja ka qenë me leje vjetore, atëherë do të kishin përfunduar brenda afatit të gjykimit edhe çështja që i përket kategorisë

⁸⁴ Në tabelën nr. 8, rezulton të jetë shënuar si e gjykuar jashtë afatit edhe çështja me nr. rendor 1, e cila bën pjesë në kategorinë e çështjeve me objekt vepra penale që dënohen jo më pak se 10 vjet burgim dhe është gjykuar përkatësisht në afatin 238 ditë. Ndërkohë, pika 5/a e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 12 muaj. Pra, efektivisht rezulton se kjo çështje është gjykuar brenda afatit standard minimal të parashikuar.

“Familjare me palë kundërshtare” me nr. rendor 34,⁸⁵ si dhe çështja që i përket kategorisë “Seancë paraprake” me nr. rendor. 18.⁸⁶

Nëse nga numri i çështjeve të gjykuara jashtë afatit standard minimal do të zbriteshin çështjet e analizuara më sipër, atëherë do të rezultonte se nga 212 çështje për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 22 çështje janë gjykuar jashtë këtij afati. Pra, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar jashtë standardit minimal kohor 10.4% të çështjeve.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, të analizuara në mënyrë matematikore e logjike, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtares, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi nuk është respektuar në 10.4% të numrit total të çështjeve për të cilat zbatohen standarde minimale kohore. Për pasojë, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në lidhje me këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Plotësimi i standardeve minimale kohore” gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve.

Konkretisht, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje për kategori, rezulton si më poshtë:

- (i) Për kategorinë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare rezulton të jetë 143 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej gjashtë muajsh.
- (ii) Për kategorinë “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, koha mesatare rezulton të jetë 18 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej dy muajsh.
- (iii) Për kategorinë “Familjare me palë kundërshtare”, koha mesatare rezulton të jetë 67

⁸⁵ Kjo çështje rezulton t’i jetë caktuar gjyqtares me short më datë 24.05.2022, ndërkohë që vendimi rezulton të jetë dhënë më datë 19.10.2022. Rrjedhimisht, duke zbritur periudhën e lejes vjetore, çështja rezulton të jetë gjykuar në afatin 111 ditë, pra brenda afatit standard që i përket kategorisë së çështjeve “familjare me palë kundërshtare”.

⁸⁶ Kjo çështje rezulton t’i jetë caktuar gjyqtares me short më datë 19.07.2022, ndërkohë që vendimi rezulton të jetë dhënë më datë 06.10.2022. Rrjedhimisht, duke zbritur periudhën e lejes vjetore, çështja rezulton të jetë gjykuar në afatin 43 ditë, pra brenda afatit standard që i përket kategorisë së çështjeve “seancë paraprake”.

- ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej katër muajsh.
- (iv) Për kategorinë “*Familjare pa palë kundërshtare*”, koha mesatare rezulton të jetë 114 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar prej dy muajsh, duke u tejkaluar ky afat me 54 ditë.
- (v) Për kategorinë “*Tregtare me palë kundërshtarë*”, koha mesatare rezulton të jetë 1 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej gjashtë muajsh.
- (vi) Për kategorinë “*Marrëdhënie pune*”, koha mesatare rezulton të jetë 110 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej gjashtë muajsh.
- (vii) Për kategorinë “*Krime*”, koha mesatare rezulton të jetë 83 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej nëntë dhe dymbëdhjetë muajsh.
- (viii) Për kategorinë “*Kundërvajtje*”, koha mesatare rezulton të jetë 91 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej katër muajsh.
- (ix) Për kategorinë “*Kërkesa penale të hetimit paraprak*”, koha mesatare rezulton të jetë 11 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej dy muajsh.
- (x) Për kategorinë “*Seancë paraprake*”, koha mesatare rezulton të jetë 36 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej dy muajsh.
- (xi) Për kategorinë “*Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*”, koha mesatare rezulton të jetë 34 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej dy muajsh.

Duke u bazuar vetëm në analizën matematikore të të dhënave, rezulton se nga 11 kategori çështjesh, për 10 prej tyre (shumicën) koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është me e shkurtër se standardi minimal kohor.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja ka sqaruar për çdo kategori shkaqet e përgjithshme që kanë ndikuar në tejkalimin e afatit standard minimal dhe ka konkluduar se në asnjë rast tejkalimi i afateve ligjore nuk ka qenë prej neglizhencës ose paaftësisë së saj për të menaxhuar një proces gjyqësor. Rrjedhimisht, ajo ka kërkuar të vlerësohet maksimalisht, pasi në çdo rast nga ana e saj janë marrë masat e nevojshme që seancat e caktuara të mos shtyhen për shkaqe të pa bazuara në ligj

KONKLUZIONE:

Në tërësi, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve dhe sipas Metodologjisë së Pikëzimit ky tregues pikëzohet me 4 pikë. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e gjatë se standardi vetëm për kategorinë “*Familjare pa palë kundërshtare*”, në të cilën rezulton të jenë gjykuar jashtë afatit standard vetëm tre çështje, dy nga të cilat kanë pasur për objekt “*Miratim familje kujdestare*”, gjykim për të cilin edhe pse nuk ka afate ligjore shqyrtimi, natyra e çështjes kërkon kujdes të shtuar nga ana e gjyqtarës për ta gjykuar në një kohë sa më të shpejtë. Këto dy çështje janë gjykuar respektivisht për 183 dhe 181 ditë dhe vetëm për njërin prej tyre rezulton të ketë ndikuar periodha e lejes vjetore, e cila edhe nëse do të zbritej, përsëri çështja rezulton e shqyrtuar jashtë afatit standard. Nga ana tjetër ngarkesa në punë e gjyqtarës në total 315 çështje në gjykim në

vitin 2022 (43 çështje të mbartura nga viti 2021 dhe 272 çështje të marra rishtazi në gjykim për vitin 2022), nga të cilat 112 çështje pa palë kundërshtare, në analizë logjike nuk justifikon zbatimin e një shkalle më të lartë pikëzimi se ajo që rezulton nga analiza matematikore.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, konsiderohet më e shkurtër se standardi minimal kohor për shumicën e kategorive të çështjeve, prandaj në lidhje me këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 4 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, si raport mes numrit të çështjeve të përfunduara (280 çështje), me numrin e çështjeve të caktuara brenda vitit kalendarik (272 çështje), rezulton 103%.

Në Formuarin e Vlerësimit gjyqtarja ka theksuar se rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore është 103%, e për pasojë në lidhje me këtë tregues duhet të vlerësohet maksimalisht.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, përqindjes së mësipërme (+99%) i përkon pikëzimi maksimal me 10 pikë.

KONKLUZIONE:

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 10 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me nivelin maksimal 10 pikë, pasi rendimenti rezulton në masën 103%.

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh, krahasuar me afatin procedural të parashikuar nga nenet respektive të K.Pr.P, është si më poshtë:

- (i) Në çështjet e kategorisë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare” koha mesatare e arsytimit është 8 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civile.

- (ii) Në çështjet e kategorisë *“Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”* koha mesatare e arsyetimit është 8 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civile.
- (iii) Në çështjet e kategorisë *“Familjare me palë kundërshtare”* koha mesatare e arsyetimit është 16 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civile.
- (iv) Në çështjet e kategorisë *“Familjare pa palë kundërshtare”* koha mesatare e arsyetimit është 14 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civile.
- (v) Në çështjet e kategorisë *“Tregtare me palë kundërshtare”* koha mesatare e arsyetimit është 1 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civile.
- (vi) Në çështjet e kategorisë *“Marrëdhënie pune”* koha mesatare e arsyetimit është 8,5 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K.Pr.Civile.
- (vii) Në çështjet e kategorisë *“Krime”* koha mesatare e arsyetimit është 23 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K.Pr.Penale.
- (viii) Në çështjet e kategorisë *“Kundërvajtje”* koha mesatare e arsyetimit është 23 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K.Pr.Penale.
- (ix) Në çështjet e kategorisë të kategorisë *“Kërkesa penale të hetimit paraprak”* koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është:
- Për kërkesa me objekt vleftësim arresti/ndalimi dhe caktim mase sigurimi, për afërsisht 5 ditë, pra sa afati procedural i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 të K.Pr.Penale.
 - Për kërkesa me objekt caktim mase sigurimi, koha mesatare e arsyetimit është 1 ditë, pra më e gjatë se afati procedural i parashikuar nga neni 244/1 i K.Pr.Penale, i cili kërkon që vendimi të jepet i arsyetuar.
 - Për kërkesa me objekt zëvendësim/revokim mase sigurimi, 13,5 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 i K.Pr.Penale.
 - Për kërkesa me objekt shuarje mase sigurimi, për afërsisht 2 ditë, pra sa afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni 261/3 dhe 248/2 i K.Penal.
 - Për kërkesa me objekt lejim përgjimi/zgjatje afat përgjimi, 22 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 24 orë i parashikuar nga neni 222 i K.Pr.Penale.
 - Për kërkesa me objekt për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, 6 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K.Pr.Penale.

(x) Në çështjet e kategorisë *“Seancë paraprake”* koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është:

- Për çështje me objekt dërgimin e çështjes në gjyq, 12 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 10 ditë i parashikuar nga neni 332/dh i K.Pr.Penale.
- Për çështje për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, 19 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K.Pr.Penale.

(xi) Në çështjet e kategorisë *“Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë”* me objekt për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit koha mesatare e arsyetimit është 11 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K.Pr.Penale.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja ka parashtruar se të gjitha vendimet gjyqësore janë arsyetuar brenda afatit të parashikuar. Ndërkohë, ajo ka sqaruar se referuar të dhënave statistikore rezulton se për disa çështje, dorëzimi i vendimeve është bërë jashtë afatit pasi statistikatat referojnë datën se kur sekretarja e gjyqtares ka depozituar fizikisht fashikullin e gjykimit në Kryesekretari dhe jo datën kur ajo efektivisht ka dorëzuar vendimin e arsyetuar.

Nga analiza e integruar e të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se afati i arsyetimit të vendimit gjyqësor është tejkaluar vetëm për tre nga gjashtë nënkategoritë e kategorisë së çështjeve *“Kërkesa penale të hetimit paraprak”*, përkatësisht për çështjet me objekt caktim *“Mase sigurimi”*, me objekt *“Zëvendësim/revokim mase sigurimi”*, me objekt *“Lejim përgjimi”*, si dhe për një nga dy nënkategoritë e kategorisë *“Seancë paraprake”*, përkatësisht çështjet me objekt *“Dërgim në gjyq”*. Rrjedhimisht, duke mbajtur në konsideratë gjithashtu se në çështjet me objekt *“Masë sigurimi”* dhe *“Lejim përgjimi”* për shkak të karakterit sekret, data e dorëzimit të vendimit të arsyetuar jo domosdoshmërisht lidhet me datën e dorëzimit të dosjes në sekretarinë gjyqësore, si dhe se për çështjet me objekt *“Dërgim në gjyq”* afati i arsyetimit të vendimit është tejkaluar vetëm me dy ditë, vlerësohet se koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor për të gjitha kategoritë e çështjeve rezulton më shkurtër ose e barabartë me afatin procedural.

KONKLUZIONE:

Për sa më sipër, vlerësohet se koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor rezulton më shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, duke treguar shkallë të lartë të aftësisë së gjyqtares për këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues pikëzohet me 15 pikë.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive

Referuar tabelave me të dhëna statistikore dhe raportit analitik, rezulton se ka mungesë të të dhënave për numrin e seancave gjyqësore për të gjitha çështjet pasi të dhënat e pasqyruara nuk përmbajnë vetëm numrin e seancave gjyqësore, por numrin e përbashkët të tyre me seancat përgatitore. Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, treguesi i numrit të seancave për çështje bëhet pjesë e vlerësimit etik dhe profesional kur statistikatat mundësohen në rrugë elektronike. Nëse kjo nuk është e mundur, ky tregues për vlerësimin dhe zvarritjen e gjykimeve, identifikohet dhe vlerësohet vetëm për çështjet e zgjedhura me short.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore referuar çështjeve me palë kundërshtarë, të përzgjedhura me short është 1,2. Konkretisht, referuar dosjeve të përzgjedhura me short, përgjithësisht gjyqtarja ka përfunduar gjykimin me një seancë gjyqësore. Përfundimisht, vetëm në çështjen penale me nr. 86 vendimi, datë vendimi 23.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, janë planifikuar dy seanca, ku seanca e parë është shtyrë në kushtet e pamundësisë së gjyqtarës për të zhvilluar gjykimin për shkak të paaftësisë shëndetësore (*vërtetuar me raportin për paaftësi të përkohshme në punë*). Ndërkohë, seanca e dytë rezulton të jetë zhvilluar rregullisht dhe të ketë përfunduar me shpalljen e vendimit gjyqësor.

Referuar analizës së mësipërme, sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive, duke iu referuar raportit analitik dhe akteve të dosjeve të përzgjedhura me short, konstatohet se gjyqtarja është kujdesur në mënyrë të veçantë për shmangien e seancave joproductive.

Gjyqtarja , në Formularin e Integruar të Vlerësimit, lidhur me këtë tregues ka parashtruar se është kujdesur të marrë të gjitha masat e nevojshme për realizimin e seancave produktive dhe shmangien e atyre joproductive.

KONKLUSIONE:

Referuar sa më sipër, për treguesin “Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive”, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 1 (një). Rrjedhimisht, gjyqtarja vlerësohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues rezulton shumë e lartë pasi numri mesatar i seancave gjyqësore rezulton të jetë 1, e rrjedhimisht pikëzohet me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se: Gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjet gjyqësore duke marrë vendimin përkatës pas caktimit të çështjes me short, referuar parashikimeve ligjore sipas kategorive të çështjeve. Konkretisht në çështjet civile, gjyqtarja ka marrë vendim për njoftimin e palës së paditur në lidhje me kërkesëpadinë dhe aktet e saj, si dhe të drejtën për paraqitjen e deklaratës së mbrojtjes (*konform nenit 158 të ndryshuar të K.Pr.Civile*), për të vijuar më pas me vendimin për caktimin e provave (*konform nenit 158/a të K.Pr.Civile*) dhe urdhrin për caktimin e seancës gjyqësore (*konform nenit 158/c të K.Pr.Civile*). Në çështjen penale të themelit, konstatohet se gjyqtarja ka vënë në lëvizje dosjen në respektim të nenit 333/1 të K.Pr.Penale. Në çështjet penale të kategorisë seancë paraprake, konstatohet se gjithmonë gjyqtarja ka vënë dosjen në lëvizje brenda 5 ditëve, sikundër parashikohet në nenin 332/1 të K.Pr.Penale për çështjet me objekt dërgimin e çështjes në gjyq dhe nenin 329/b të K.Pr.Penale për me objekt pushimin e procedimit penal. Në një çështje me karakter emergjent, e cila është kërkesë penale e fazës së hetimit paraprak me objekt vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit personal, seanca është caktuar menjëherë pas regjistrimit dhe shortimit të saj dhe gjykimi është planifikuar dhe përfunduar ditën e nesërme, duke respektuar afatin 48 orë të parashikuar nga nenet 258-259 i K.Pr.Penale.

Në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtarja jo vetëm i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore duke caktuar seancën, por duke treguar edhe kujdesin maksimal për marrjen e masave për njoftimin e palëve me qëllim zhvillimin e seancave gjyqësore efektive. Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligj për gjykimin në shkallë të parë si në çështjet civile (*nenet 171 e vijues të K.Pr.Civile*) ashtu edhe në çështjet penale (*neni 405 i K.Pr.Penale*) apo sipas ritit të gjykimeve të seancave paraprake (*neni 332/c dhe 329/b i K.Pr.Penale të ndryshuar me ligjin nr. 35/2017*).

Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të palës paditur apo pa praninë e të pandehurit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve,

shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, si dhe zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit. Drejtimi i seancës zhvillohet nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes. Gjithashtu, rezulton që gjykata ka disponuar me vendime të ndërmjetme mbi çdo kërkesë të parashtruar nga palët në gjykim apo edhe vendimet e ndërmjetme të marra kryesisht.

Në dosjet e vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur përgjithësisht në kohë (*ose me vonesa të papërfillshme*). Vetëm në një rast, seanca rezulton të ketë filluar me vonesë mbi 15 minuta nga orari i planifikuar, duke relatuar edhe shkakun përkatës.⁸⁷

Gjyqtarja , në Formularin e Integruar të Vlerësimit, lidhur me këtë tregues ka parashtruar se ka treguar kujdes maksimal në respektimin me rigorozitet të të gjitha fazave të gjykimit, duke filluar nga vënia në lëvizje e dosjes, ezaurimi i të gjitha veprimeve paraprake apo përgatitore të nevojshme, si dhe drejtimi i një procesi të rregullt gjyqësor, duke orientuar drejt debatin mes palëve, e duke u shprehur me urdhra dhe vendime të ndërmjetme për kërkesat e tyre.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në raportin analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur në përgjithësi me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” është “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtares për të administruar dosjen gjyqësore

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes

Nga vëzhgimi i dosjeve të 6 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se dosjet janë renditura në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve.

Renditja e dosjeve zhvillohet kryesisht të njëjtën linjë në të 6 dosjet e vëzhguara, duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Në këtë mënyrë, brenda kategorisë, aktet renditen sipas

⁸⁷ Vendim nr. 86, datë 23.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

datave (njoftimet, shkresat, procesverbalet e seancave), duke e bërë dosjen lehtësisht të aksesueshme.

Në aspektin formal, dosjet paraqiten të rregullta, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara, të renditura në mënyrë logjike dhe orientojnë drejt lexuesin për vendndodhje e tyre duke krijuar mundësi për tu shfrytëzuar me lehtësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik rezulton se në dosje ndodhen të gjitha aktet dhe dokumentacioni i administruar gjatë gjykimit. Në çdo dosje administrohen aktet shkresore të hartuara nga gjykata (njoftimet, shkresat, procesverbalet, vendimi gjyqësor), si dhe aktet e paraqitura nga palët (kërkesa objekt gjykimi, provat e administruara, kërkesat me shkrim të palëve, diskutimet përfundimtare të tyre).

Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, dokumentacioni i dosjeve të vëzhguara është i saktë dhe i plotë, nuk konstatohen mungesa aktesh dhe nuk konstatohet në dosje dokumentacion i cili nuk i përket çështjeve konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, është “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
99	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se për gjyqtaren {...}, gjatë periudhës së vlerësimit nuk janë dhënë ose zbatuar masa disiplinore.

Sa i përket ankesave, për periudhën e vlerësimit viti 2022, ndaj gjyqtares, sipas informacionit të përcjellë nga ILD rezulton të jenë regjistruar dhe trajtuar nga ana e ILD-së 3 (tre) ankesa, si vijon:

i) Ankesë e z. H.L, ankesë e regjistruar pranë ILD-së me nr. 724 prot., datë 31.03.2022. Përmes ankesës së paraqitur, ankuesi ka pretenduar se vendimi nr. 91, datë 23.03.2022 i gjyqtares subjekt vlerësimi nuk është arsyetuar, është jologjik dhe përmban interpretim ekstraprocedural të nenit 154/a të K.Pr.Civile. Gjithashtu, ankuesi ka pretenduar edhe për zvarritje të të procesit, si pasojë e disponimit për “*kthim të kërkesëpadisë dhe akteve*”, për mosgjykim brenda afatit pesë ditor të kërkesës për masën e sigurimit të padisë, si dhe paragjykim në zgjidhjen e çështjes. Me vendimin nr. 724/3, datë 01.06.2022, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë në shqyrtim secilin prej pretendimeve të ngritura nga ana e ankuesit. Konkretisht, në lidhje me pretendimet për vlerësim jologjik të kërkesëpadisë dhe mosarsyetim të vendimmarrjes, është konstatuar se gjyqtarja ka cituar bazën ligjore dhe ka evidentuar paqartësinë e objektit të kërkimit dhe dokumentacionin e munguar, dokumentacioni i cili në ankesën e paraqitur nuk pretendohet të ketë qenë bashkëlidhur. Sa i takon pretendimeve për zvarritje, është sqaruar se çështja është regjistruar në gjykatë më datë 16.03.2022 dhe vendimi është marrë më 23.03.2022, duke pasqyruar edhe rregullat e shortit referuar vendimit të ish-KLD nr. 238/1, datë 24.12.2008, sipas të cilave hedhja e shortit jo domosdoshmërisht kryhej në ditën e regjistrimit, por mund të kryhej edhe në ditën pasardhëse, në varësi të ngarkesës së gjykatës. Së fundi, sa i takon pretendimit për paragjykim në zgjidhjen e çështjes, nuk është evidentuar asnjë fakt apo rrethanë prej nga mund të arrihej në një konkluzion të tillë. Pavarësisht këtyre verifikimeve dhe argumentimeve, duke qenë se pretendimet e ankuesit kryesisht kanë të bëjnë me zbatim të gabuar apo mosrespektim të ligjit procedural apo material, është konkluduar se kompetenca i përket gjykatës më të lartë dhe jo Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Rrjedhimisht, në përfundim është disponuar “*Për arkivimin, pas shqyrtimit fillestar të ankesës së z. H.L.*”.

ii) Ankesë e znj. E.Sh, ankesë e regjistruar pranë ILD-së me nr. 490 prot., datë 01.03.2022. Përmes kësaj ankese, ankuesja ka parashtruar se ushtron detyrën e psikologes, është e licensuar dhe e regjistruar në regjistrin elektronik të Ministrisë së Drejtësisë dhe ka punuar si eksperte në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër për një kohë të gjatë. Më pas, ajo është larguar për probleme shëndetësore, për t'u rikthyer dhe vijuar punën sërish, por që sipas saj, drejtuesja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, si dhe gjyqtarët e tjerë të kësaj gjykate, nuk e kanë caktuar si eksperte. Ndërkohë, ata caktojnë ekspertë të tjerë të palicensuar dhe të paregjistruar në Ministrinë e Drejtësisë. Pas shqyrtimit fillestar të kësaj ankese, duke vlerësuar se në lidhje me faktin e parashtruar ka një vendimmarrje të mëparshme, me të cilën është disponuar arkivimi i saj, me vendimin nr. 1995/1, datë 29.06.2023, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka disponuar *“Për arkivimin, pas shqyrtimit fillestar të ankesës së znj. E.Sh.”*.

iii) Ankesë e znj. M.J përmes av. A.J, ankesë e regjistruar pranë ILD-së me nr. 1189 prot., datë 09.05.2022. Përmes kësaj ankese, ankuesi ngre pretendimet si vijon: i) për mosdhënien e të dhënave, akteve, procesverbaleve gjyqësore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, për çështjet që janë në shqyrtim apo kanë përfunduar ku ankuesi është apo ka qenë palë në proces; ii) për mosgjykimin e anikimeve të paraqitura nga av. A.J; iii) për vendimin nr. 102, datë 05.04.2022 të gjyqtares subjekt vlerësimi, me objekt vërtetimin e faktit juridik. Me vendimin nr. 1204/1, datë 27.06.2023, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë në shqyrtim secilin prej pretendimeve të ngritura nga ana e ankuesit. Konkretisht, në lidhje me pretendimet për mosdhënien e të dhënave, akteve, procesverbaleve për çështjet që janë në shqyrtim apo kanë përfunduar dhe ku ankuesi është apo ka qenë palë në proces, është evidentuar se këto pretendime janë jashtë veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke qenë se ato lidhen me veprimtarinë e nëpunësve civilë gjyqësore, e si të tilla duhet të adresohen pranë Kancelarit apo Kryetarit të Gjykatës, në varësi të pretendimit. Ndërkohë, sa i takon pretendimeve të tjera, është arsyetuar se ato janë kompetencë e shqyrtimit nga gjykata më e lartë. Në të tilla rrethana, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka konkluduar se ankesa nuk përmbush kriteret e pranueshmërisë referuar nenit 120/1, shkronja d dhe dh të ligjit nr. 96/2016, e rrjedhimisht ka disponuar *“Për arkivimin, pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga znj. M.J dhe z. A.J.”*.

Në formularin e integruar të vlerësimit gjyqtarja ka parashtruar se gjatë ushtrimit të funksionit nuk ka pasur sjellje në kundërshtim me rregullat e etikës gjyqësore dhe se debati gjyqësor është drejtuar duke mos përdorur fjalë dhe shprehje që cenojnë etikën apo dinjitetin e palëve.

KONKLUZIONE:

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna që mund të tregojnë cenimin e etikës, angazhimin apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtares, shfaqje të sjelljeve që tregojnë mungesë respekti, vetëpërbajtje, ndjeshmërie, vëmendje, apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive, gjatë ushtrimit të detyrës. Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri të lartë në funksion dhe nuk ka shfaqur sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë dhe pikëzohet me pikët maksimale.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, etika e gjyqtarës në lidhje me treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.

3.B Integriteti i gjyqtarës

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, rezulton se për gjyqtaren {...} janë paraqitur tre ankesa, të cilat është vendosur të arkivohen. Ndërkohë, ndaj saj nuk rezulton të jenë marrë apo zbatuar masa disiplinore.

Në raportin e ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr. 1850/1, datë 02.05.2023, është konkluduar se: “Në përfundim të kontrollit të plotë të deklaratave të interesave periodike vjetore 2017-2020, ka rezultuar se: a) Deklaratat e interesave private periodike vjetore 2017-2020 janë dorëzuar brenda afateve ligjore; b)Gjatë kontrollit u konstatua se deklaratat e interesave private janë plotësuar në përputhje me ligjin; c)Nga kontrolli i ushtruar nuk u verifikuan raste të konfliktit të interesit.”.

Në lidhje me këtë tregues, në formularin e integruar të vetëvlerësimit, gjyqtarja është shprehur se gjatë ushtrimit të detyrës nuk ka kryer veprime ose sjellje që cenojnë integritetin, nderin dhe dinjitetin e figurës së gjyqtarës.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicje që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarës, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim apo çdo sjelle tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtarës.

KONKLUZIONE:

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin e gjyqtarës, gjyqtarja pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjellëve të pahijshme apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarës.

Shkalla e integritetit të gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e integritetit të gjyqtarës në treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C Paanësia e gjyqtares

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në raportin analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve të administruara në dosjet e gjykimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtares.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares në lidhje me treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit 01 janar 2022-31 dhjetor 2022, janë paraqitur 8 kërkesa për përjashtimin e gjyqtares, të cilat rezultojnë të jenë rrëzuar. Gjithashtu, rezulton që vetë gjyqtarja ka paraqitur 2 kërkesa për heqje dorë nga gjykimi, të cilat janë pranuar.

Gjyqtarja në vetëvlerësimin e saj është shprehur se gjatë ushtrimit të detyrës nuk ka shfaqur sjellje që tregojnë njëanshmëri ndaj njërit prej palëve. Edhe në rastet kur janë paraqitur kërkesat për përjashtim, nëpërmjet vendimeve gjyqësore të dhëna në këto raste dhe sanksioneve të vendosura ndaj palëve apo përfaqësuesve të tyre ligjorë, është provuar se kanë qenë abuzive dhe përpjekje për të zvarritur procesin gjyqësor.

Në tërësi, për këtë tregues numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares, vlerësohet si “I pa konsiderueshëm”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet si “I pa konsiderueshëm”.

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarës në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezultojnë se gjyqtarja gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e drejtpërdrejtë, e qartë, transparente, e kuptueshme, duke respektuar të drejtat e palëve dhe duke treguar kujdes për të treguar trajtim të barabartë dhe me dinjitet të tyre. Gjithashtu, rezultojnë komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe për pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë.

Në komunikimin shkresor me subjektet palë ose jo në procesin gjyqësor, gjuha e përdorur është korrekte, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

Të njëjtat cilësi evidentohen edhe në vetëvlerësimin e gjyqtarës lidhur me këtë tregues.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezultojnë se gjyqtarja në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes për të qenë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale për të cilat gjyqtarja vihet në dijeni për shkak të funksionit. Në çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton të ketë pasur të dhëna me karakter sensitiv apo personal. Gjithashtu, nga burimet e tjera të vlerësimit nuk ka asnjë të dhënë apo indicje për cenim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale të palëve apo pjesëmarrësve në gjykim.

KONKLUZIONE:

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “E lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar.

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit.

Gjyqtarja në formularin e vetëvlerësimit e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët është në nivel maksimal, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale,

përfshirjen në diskutime ligjore, organizimin e punës në gjykatë dhe komunikimin brenda trupave gjyqësore.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.*

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore ndërkohë që edhe gjyqtarja e vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë duke parashtruar se ka komunikim dhe ndërveprim shumë të lartë me stafin e gjykatës dhe ka krijuar një marrëdhënie harmonike dhe bashkëpunuese me ta.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarës me administratën gjyqësore, është shumë e lartë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.*

4.C Gatishmëria e gjyqtarës për t’u angazhuar në veprimtari të tjera

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarës në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë periudhës së vlerësimit viti 2022, ka marrë pjesë në 12 aktivitete trajnuese, të cilat janë pjesë e Programit të Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në

tërësi, aktivitetet trajnuese në të cilat ajo ka marrë pjesë janë shtrirë në një periudhë kohore prej 15 ditësh.

Sipas parashikimeve të nenit 5 pika 3 të Ligjit për Statusin *periudha e formimit vazhdues duhet të jetë: a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve; b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve.* Në rastin konkret gjyqtarja ka marrë pjesë në 12 aktivitete trajnuese të shtrira në 15 ditë trajnimi, brenda kufijve minimale dhe maksimalë (5 deri në 40 ditë në vit) të përcaktuara nga Ligji për Statusin, duke përmbushur detyrimin ligjor për pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese të përshtatshme për funksionin e saj dhe që i përkasin fushës së veprimtarisë së saj pasi rezultojnë të jenë aktivitete me tema të së drejtës procedurale dhe materiale penale si dhe në fushën e të drejtave të njeriut.

KONKLUZIONE:

Nga analiza e të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në 12 aktivitete trajnuese të shtrira në 15 ditë trajnimi, brenda kufijve minimale dhe maksimalë (5 deri në 40 ditë në vit) të përcaktuara nga Ligji për Statusin.

Pjesëmarrja e gjyqtarës në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, pjesëmarrja e gjyqtarës në aktivitetet trajnuese të Sh. M pikëzohet me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk evidentohet angazhimi i gjyqtarës {...} në cilësinë e ekspertit ose lehtësuesit në aktivitete trajnuese. Në formularin e vetëvlerësimit, gjyqtarja ka deklaruar se ushtrimi i funksionit në një gjykatë larg Tiranës, delegimet në gjykata të tjera përveç asaj ku ka ushtruar funksionet, veprimtaria administrative në cilësinë e Zv.Kryetarit të Gjykatës dhe ngarkesa në këtë pozicion, kanë bërë të pamundur angazhimin në këtë drejtim.

Lidhur me disponueshmërinë e saj për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional, gjyqtarja është shprehur se në periudhën e vlerësimit nuk është caktuar asnjëherë si gjyqtar udhëheqës në praktikën profesionale të kandidatëve për gjyqtarë, por gatishmëria për të kontribuar në këtë drejtim nuk ka munguar.

KONKLUZIONE:

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarës, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, pavarësisht nga frekuenca e angazhimit, për gjyqtaren

{...}, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për përfshirjen e saj në cilësinë e ekspertit/lehtësuesit në aktivitete të trajnimit vazhdues pranë SHM apo aktivitete të organizuara nga institucione/organizata të tjera, ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

Disponueshmëria e gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtarja pikëzohet me 3 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarës në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezultojnë të dhëna konkrete për pjesëmarrjen e gjyqtarës në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Në formularin e vetëvlerësimit, gjyqtarja është shprehur se gjatë periudhës së vlerësimit, është përpjekur të jap kontributin qoftë në bashkëpunimin ndër-institucional apo edhe me grupet e interesave me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit.

KONKLUZIONE:

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarës, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {...}, duke qenë se rezultojnë nuk rezultojnë të dhëna për kontributin konkret, ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Angazhimi i gjyqtarës në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” gjyqtarja pikëzohet me 3 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtarës në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezultojnë të dhëna.

KONKLUSIONE:

Për sa më sipër, në mungesë të të dhënave për këtë tregues, gjyqtarja pikëzohet me 0 (zero) pikë.

Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezulton angazhim i gjyqtares dhe për këtë shkak pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
91	Shkëlqyeshëm

**NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE
NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT**

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtares	98	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtares	99	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	388	Shkëlqyeshëm

PROPOZIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93 pika 5 shkronja “ç” të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtarja {...} të mbajë në konsideratë angazhimin e saj të vazhdueshëm në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit të saj për përmirësimin e sistemit gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA 1
KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...}
PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2022- 31 DHJETOR 2022

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES				Pikët total	Niveli i vlerësimit	
				98	Shkëlqyeshëm	
Treguesit	Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologjinë		
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtares 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtares 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtares 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares	Shumë e lartë	15	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë	

		3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim			Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarës 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Mbi mesataren	8	Shkalla e aftësisë së gjyqtarës: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarës 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarës: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				99	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10 %	15	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë

	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10%	5	Jashtë afatit: Mbi 40 %- 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve	4	Koha mesatare: Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	98.83 %	10	Tej standardit : Nën 81 %- 2 pikë Mbi 81-87 % - 4 pikë Mbi 87- 93 % - 6 pikë Mbi 93-99 % - 8 pikë +99% - 10 pikë

	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve	15	Koha mesatare: Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë
B. Aftësia e gjyqtarës për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarës: Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë

					1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtarës: E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
C. Aftësia e gjyqtarës për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së gjyqtarës: E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarës	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarës: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues	Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia	

A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Vetëvlerësimi i gjyqtares 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e gjyqtares: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
B. Integriteti i gjyqtares	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të gjyqtares : E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
C. Paanësia e gjyqtares	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë

	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm	15	Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				91	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e për zgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të për zgjedhura me short	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparenca e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e për zgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të për zgjedhura me short	I lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
B. Aftësia për të	a. Shkalla e komunikimit dhe	1. Vetëvlerësimi i	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit:

bashkëpunuar	bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	gjqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave			E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë	
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë	
C. Gatishmëria e gjyqtares për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtares në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtarja	5-40 ditë (Periudha 1/vjeçare)	20	Pjesëmarrja e gjyqtares: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4	
	b. Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtares 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Nuk ka të dhëna		3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtares 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen	Nuk ka të dhëna		3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë

	profesionale të gjyqtares			
ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtares 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të tij	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
KËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT		388		
VELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARES		Shkëlqyeshëm		

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

